



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL

**PËR MARRJEN E LICENCËS SË AVANCUAR PËR
MËSIMDHËNIE
MËSIMDHËNËS TË LËNDËS
“GJUHË SHQIPE”**

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL

**PËR MARRJEN E LICENCËS SË AVANCUAR PËR
MËSIMDHËNIE**

**MËSIMDHËNËS TË LËNDËS
“GJUHË SHQIPE”**

Shkurtesat

AF	Arsimi Fillor
AML	Arsimi i Mesëm i Lartë
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulët
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FE	Fakulteti i Edukimit
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
ISCED	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
KB	Kurrikula Bërthamë
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KSZHM	Kornizë strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve
KSHLM	<i>Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve</i>
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PISA	Program për Vlerësim Ndërkombëtar të Studentëve
PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UA	Udhëzim Administrativ
VPM	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
ZHPBSH	Zhvillim Profesional me Bazë në Shkollë
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

SHËNIM: Ky dokument bazohet në materialet e përgatitura nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) në Republikën e Shqipërisë. Përshatja e me kontekstin dhe specifikat e arsimit në Kosovë, është bërë me marrëveshje dhe në bashkëpunim me ekspertë nga ASCAP.

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat.....	2
1. Hyrje	4
1.1. Synimet dhe qëllimet e programit të zhvillimit profesional për Licencë të avancuar për mësues të gjuhës shqipe	4
2. Përmbajtja e programit për licencë të avancuar për mësues të lëndës Gjuhë shqipe	6
2.1.Fusha: Dokumentacioni zyrtar shkollor	7
2.2. Fusha: Kurrikula - programet lëndore të Gjuhës shqipe	7
2.3. Fusha: Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë, vlerësimit dhe përdorimit të TIK-ut në mësues nxënëse.....	8
2.4.Fusha: Gjithëpërfshirja dhe etika në profesion.....	10
2.5.Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	11
2.6. Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndës	12
3. Modele të testeve për mësues të lëndës Gjuhë shqipe	12
3.1. Modeli i testit të lëndës “Gjuhë shqipe”, Arsimit të Mesëm të Ulët (AMU).....	14

1. Hyrje

Profesioni i mësimdhënësit është profesion dinamik i cili kalon nëpër faza të ndryshme të zhvillimit në karrierë. Lidhet me kualifikimin akademik për të ushtruar profesionin e mësimdhënësit dhe me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të orientuar me standarde dhe tregues të performancës. Nga kjo perspektivë, mësimdhënësit përgatiten në disa aspekte, si:

- Të veprojnë me profesionalizëm, ndershmëri dhe integritet;
- Të kenë njohuri të duhura dhe të nevojshme shkencore për fushën përkatëse të mësimdhënies;
- Të zhvillojnë praktika cilësore të mësimdhënies;
- Të përditësojnë njohuritë dhe shkathtësitë pedagogjike, metodike, didaktike, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe hulumtimit të praktikave të reja mësimore;
- Të krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale, si dhe
- Të bashkëpunojnë me prindërit dhe komunitetin e shkollës në interesin më të mirë të nxënësve, përkatësisht në funksion të të mësuarit të secilit nxënës.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – për mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe” – është pjesë e paketës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve, e cila udhëheq zhvillimin e mësimdhënësve për të arritur standarde të larta në punë dhe në sjellje që lidhen me pritshmëritë për mësimdhënës të avancuar. Programi është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) për t’u ardhur në ndihmë:

- Të gjithë mësimdhënësve të lëndës së Gjuhës shqipe në përgatitjen për provimin kualifikues dhe për vlerësimin e performancës për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- Të gjithë mekanizmave që merren me organizimin e provimit të kualifikimit për licencë të avancuar për mësimdhënie;
- Inspektoratit të Arsimit (IA) si bartës të procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës së mësimdhënësve (VPM) për licencë të avancuar për mësimdhënie; si dhe
- Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Shkollave për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësimdhënësit dhe për të zhvilluar përgatitjet me mësimdhënësit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave për kompetencat e mësimdhënësve që MASHTI ka vendosur në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KSZHM)¹, në dokumentet e sistemit të licencimit të mësimdhënësve, kërkesat për mësimdhënësit që synojnë marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie.

1.1. Synimet dhe qëllimet e programit të zhvillimit profesional për Licencë të avancuar për mësimdhënës të gjuhës shqipe

¹ Duke marrë për bazë referimin hyrës të dokumentit në të cilin theksohet se Korniza do të jetë një dokument i gjallë i cili do të plotësohet dhe zhvillohet vazhdimisht krahas zhvillimeve të reja në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve dhe procesit të licencimit, grupi punues ka zhvilluar më tutje aspekte të rëndësishme të fushave të zhvillimit profesional dhe të kompetencave profesionale që lidhen me marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie. Ato reflektohen në këtë program orientues të zhvillimit profesional.

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional për efekt të kualifikimit për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe” janë:

- Të ofrojë një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësimdhënësve të lëndës së Gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar, përkatësisht mësimdhënësve të Gjuhës shqipe në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe Arsimin e Mesëm të Lartë (AML) për të realizuar veprimtaritë përgatitore profesionale, trajnuese për provimin për kualifikim dhe për vlerësim të performancës për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- Të ofrojë një program orientues për t’u ardhur në ndihmë DKA-ve, shkollave dhe të gjithë ofruesve të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shërbim, për të zhvilluar dhe ofruar programe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve (ZHPM), që ndihmojnë përgatitjen e tyre për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- Të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësimdhënësit e Gjuhës shqipe që synojnë marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka procesi i provimit të kualifikimit dhe VPM për licencë të avancuar.

Programi ka për qëllim që mësimdhënësi:

- Të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit, përkatësisht çështjet kryesore që janë vendosur nga MASHTI, përgjegjësitë karshi dokumentacionit shkollor, detyrimeve dhe obligimeve të punës;
- Të tregojë kompetencë në njohjen dhe zbatimin në mënyrë efektive të kurrikulës së bazuar në kompetenca – programeve të lëndës së Gjuhës shqipe në shkollë;
- Të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale për mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- Të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve, organizimin e mjedisit të klasës, shtjellimin e koncepteve, nxitjen e diskutimeve, përdorimin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënit, përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- Të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me bazë kompetencat digjitale;
- Të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit, kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- Të demonstrojë etikë profesionale, qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve, të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës, si dhe të demonstrojë etikë profesionale;
- Të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- Të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- Të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që ndërliiden me çështjet ndërkurrikulare dhe kanë të bëjnë me edukimin për qytetari demokratike, çështjet e barazisë gjinore, edukimin për paqe, globalizimin dhe ndërvarësinë, edukimin për media, arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen.

2. Përmbajtja e programit e programit për licencë të avancuar për mësimdhënës të lëndës Gjuhë shqipe

Përmbajtja e programit orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie – mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe” – është e organizuar në dy pjesë:

- **Pjesa e parë**, përfshihen fushat kryesore të zhvillimit profesional, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme sipas kompetencave profesionale;
- **Pjesa e dytë**, përfshin dy modele testesh për lëndën e Gjuhës shqipe në secilin nivel arsimor: arsim i mesëm i ulët (AMU) dhe arsim i mesëm i lartë (AML).

Fushat kryesore të zhvillimit profesional, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme

Fushat kryesore të zhvillimit profesional ku verifikohen kompetencat e mësimdhënësve për licencë të avancuar përdoren si ombrellë udhëzuese për të përcaktuar pritshmëritë mbi të cilat organizohen kërkesat/pyetjet për instrumentet e vlerësimit për provimin e kualifikimit dhe vlerësimin e performancës, për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie. Fushat kryesore të zhvillimit profesional të përcaktuara për këtë program orientues janë:

- Dokumentacioni zyrtar² shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë edukative-arsimore të mësimdhënësve në shkollë;
- Kurrikula - programe lëndore të Gjuhës shqipe;
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies të lëndës së Gjuhës shqipe;
- Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale;
- Aspekte të drejtshkrimit të Gjuhës shqipe;
- Përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të Gjuhës shqipe.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- Kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave; dhe
- Literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të provimit të kualifikimit dhe të VPM, do ta ndihmojnë mësimdhënësin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet gjatë përgatitjes për këtë proces dhe për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Rezultatet e pritshme dhe literatura e rekomanduar për çdo fushë të zhvillimit profesional pasqyrohen në pjesën në vijim.

2 I referohet kuadrit të politikave ligjore të arsimit parauniversitar në Kosovë, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve e politikave arsimore që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

2.1. Fusha: Dokumentacioni zyrtar shkollor

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave ligjore të lidhura me dokumentacionin zyrtar shkollor”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> zbaton legjislacionin për sistemin arsimor parauniversitar, udhëzimet administrative dhe dokumentet tjera që lidhen me hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; demonstron zbatimin konkret të udhëzimeve të MASHTI-t në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies; zbaton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të profesionit; respekton të drejtat, liritë e nxënësit dhe përgjegjësitë; respekton, detyrat, të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit; zbaton kërkesat e udhëzimeve administrative dhe udhëzuesit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011). https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770 Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (MASHTI & IPK). https://ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/02/Korniza-per-sigurim-te-cilesise-se-performances-se-shkolles-ne-Kosove-2016.pdf Udhëzimi administrativ nr. 22/2016 për Aktivet profesionale (Departamentet) të shkollave. Prishtinë: MASHT. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15199 Udhëzimi Administrativ nr. 14/2023 Për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie. MASHTI. https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativmashti-nr-14-2023-per-sistemin-e-licencimit-dhe-karrieren-ne-mesimdhenie/ Udhëzimi administrativ MASHTI nr. 16/ 2023 për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/

2.2. Fusha: Kurrikula - programet lëndore të Gjuhës shqipe

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi në mënyrë efektive i kurrikulës së bazuar në kompetenca - programeve të lëndës së Gjuhës shqipe”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> zbaton kurrikulën lëndore/ programin mësimor të lëndës së Gjuhës shqipe duke respektuar të gjitha aspektet e organizimit të kurrikulës lëndore; përdor me efikasitet parimet e kurrikulës në planifikimin dhe zbatimin e programit lëndor të Gjuhës shqipe; harton dhe gjen materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në kurrikulat e lëndës së Gjuhës shqipe për nivelin përkatës të arsimit (AMU apo AML); 	<ul style="list-style-type: none"> Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar, 2016); Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës - MASHT (rks-gov.net) Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2016; KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS (Klasa VI, VII, VIII dhe IX) - MASHT (rks-gov.net) Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016; KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË TË KOSOVËS (Gjimnazet - klasa X, XI, XII) - MASHT (rks-gov.net) Kurrikulat e lëndës së Gjuhës shqipe me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX (2017 – 2020); KURRIKULAT LËNDORE/PROGRAMET MËSIMORE- KLASA E GJASHTË - MASHT (rks-gov.net)

<ul style="list-style-type: none"> • harton dhe gjen materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxënësve për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me orientimet dhe kërkesat e kurrikulës bërthamë dhe programeve të lëndës së Gjuhës shqipe; • kategorizon rezultatet e të nxënësve të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënësve; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të Gjuhës shqipe); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve të nxënësve të programit të lëndës së Gjuhës shqipe; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e Gjuhës shqipe me shkencat e tjera dhe me kontekstin e jetës së përditshme; 	<ul style="list-style-type: none"> • Kurrikulat e lëndës së Gjuhës shqipe me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X –XII (2017-2019); KURRIKULAT LËNDORE/PROGRAMET MËSIMORE- KLASA E DHJETË GJIMNAZET - MASHT (rks.gov.net)
---	---

2.3. Fusha: Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë, vlerësimit dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie

Kompetenca I “Zotërimi i kompetencës pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e Gjuhës shqipe”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij/saj; • përshtat punën e tij/saj me zhvillimin fizik, social, emocional dhe kognitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së Gjuhës shqipe; • kultivoi dashurinë dhe kërkueshmërinë ndaj lëndës së Gjuhës shqipe; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet kurrikulare – KKK dhe KB për Nivelet e arsimit (ISCED II dhe ISCED III); • Kurrikulat lëndore të lëndës së Gjuhës shqipe (klasat 6-9 dhe 10-12); • Udhëzuesi praktik për zbatimin e Kurrikulës - Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi (MASHT & IPK, 2016) • Udhëzuesit për mësimdhënës për zhvillim personal për klasat 6, 7, 8 dhe 9 (KEC, 2023). https://kec-ks.org/publikime/ • Programi i KosEd: Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi. https://eëë.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program • Mësimdhënia efektive dhe kurrikula, prof. Naser Zabeli (2023); • Teori dhe strategji të mësimdhënies – Qasja konstruktiviste, prof. Xhavit Rexhaj (2019);

<p>Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e Gjuhës shqipe”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një kompetence të caktuar apo të rezultateve të nxënit; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon dhe zhvillon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet kurrikulare – KKK dhe KB për Nivelet e arsimit (ISCED II dhe ISCED) III – pjesa e metodologjisë së mësimdhënies; • Kurrikulat lëndore të lëndës së Gjuhës shqipe (klasat 6-9 dhe 10-12) – pjesa e udhëzimeve për metodologjinë e mësimdhënies; • Udhëzuesi praktik për zbatimin e Kurrikulës - Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi (MASHT & IPK, 2016) • Mësimdhënia e bazuar në projekte - Doracak për mësimdhënësit e gjimnazeve (KEC, 2022). https://kec-ks.org/ep-content/uploads/2023/07/Mesimdhenea-e-bazuar-ne-projekte-Doracak-2.pdf • Programi i KosEd: Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi. https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program • <u>Mësimdhënia efektive dhe kurrikula, prof. Naser Zabeli (2023);</u> • <u>Teori dhe strategji të mësimdhënies – Qasja konstruktiviste, prof. Xhavit Rexhaj (2019);</u>
<p>Kompetenca III “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive për vlerësimin e nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton lloje të ndryshme të vlerësimit gjatë procesit të të nxënit; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • përdor metoda e teknika të vlerësimit formativ që nxisin nxënësit të vetë vlerësojnë (ose të vlerësojnë shokun) progresin e tyre në lëndën e Gjuhës shqipe nëpërmjet kryerjes së detyrave dhe ushtrimeve të ndryshme; • përdor teknika dhe evidenca të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon hapat dhe parimet e hartimit të një testi për nxënësit; • zhvillon teste që zbatojnë parimet e hartimit dhe të pikëzimit të një testi; • vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës (2020). https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/korniza-komplet-shqip-2.pdf • Udhëzim administrativ për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës (MASHTI, 2022) https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-mashti-06-2022-per-vleresimin-e-nxenesve-ne-arsimin-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/ • Udhëzimi Administrativ: Kodi i Etikës për Vlerësimin e Nxënësve (2011). https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf • Vlerësimi për të nxënë - Doracak për mësimdhënësit e gjimnazeve (KEC, 2022). https://kec-ks.org/ep-content/uploads/2023/07/Vleresimi-per-te-nxene-Doracak-per-mesimdhenes-2.pdf • Vlerësimi formativ (MASHT & BEP, 2013). • Vlerësimi përmbledhës dhe hartimi i testit - Doracak për mësimdhënësit (MASHT & GIZ, 2015).

	<ul style="list-style-type: none"> • Modele pyetjesh – Testi i Arritshmërisë, – Provimi i Maturës shtetërore, (Teste nga Divizioni për Standarde dhe Vlerësim në MASHTI) Lënda: Gjuhë shqipe.
<p>Kompetenca IV “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në lëndën e Gjuhës shqipe”</p>	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prezenton materiale nga lënda e Gjuhës shqipe duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Math Type në Word; • nxit nxënësit të bëjnë prezentime në Gjuhë shqipe duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga uebsajte për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së Gjuhës shqipe apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga uebsajte. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste shkollore, materiale mësimore në ndihmë të mësimdhënësve të lëndës së Gjuhës shqipe që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë, që kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie –nxënie. • Udhëzues për mësimdhënës- Udhëtimi nëpër internet (MASHTI). https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes/ • Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu) • https://shkollat.org/

2.4. Fusha: Gjithëpërfshirja dhe etika në profesion

<p>Kompetenca “Zbatimi i parimeve të gjithëpërfshirjes dhe rregullave të etikës në profesion si elemente të domosdoshme në punën e mësimdhënësit”</p>	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbaton parimet e gjithëpërfshirjes gjatë punës me nxënës dhe gjithë komunitetin e shkollës; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj veçantive të nxënësve, mënyrës se si mësojnë, si dhe i përkrah ata në arritjen e rezultateve mësimore; • përdor strategji të komunikimit që synojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënies dhe i trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt; • respekton etikën profesionale dhe sillet me përgjegjësi ndaj nxënësve, prindërve, kolegëve mësimdhënës dhe udhëheqjes së shkollës; 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi administrativ për përdorimin e planit individual të arsimit (MASHT, 2016). https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016 • Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e Planit Individual të Arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (MASHT, 2017). https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetnxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene, • Praktika të mira të gjithëpërfshirjes (MASHTI,2017) https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetnxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene , • Manual didaktik për parandalimin e dhunës (MASHT & Save the Children, 2014) https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2018/07/manuali-per-parandalimin-e-dhunes-ne-shkolla.pdf

	<ul style="list-style-type: none"> • Doracaku i kurrikulës së mësimdhënies për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë- Arsimi i mesëm i ulët (MASHT, 2020). https://masht.rks-gov.net/doracaku-i-kurrikules-se-mesimdhenes-per-paqe-dhe-ndertim-te-qendrueshmerise-arsimi-i-mesem-i-ulet/ • Doracak për mësimdhënës – Ndërkulturalizmi në arsim (MASHTI, 2023). https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-nderkulturalizmi-ne-arsim/ • Udhëzues për mësimdhënës - Të kuptojmë Aftësinë e Kufizuar (MASHTI, 2022). https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes-te-kuptojme-aftesine-e-kufizuar/ • Kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta (MASHTI, 2022). https://masht.rks-gov.net/kornize-per-perfshirjen-e-nxeneseve-me-nevoja-te-vecanta-arsimore-ne-shkollat-e-mesme-te-larta/ • Doracak për mësimdhënës me aktivitete mbi të drejtat e fëmijëve (MASHTI, 2021). https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-me-aktivitete-mbi-te-drejtat-e-femijeve-2/
--	--

2.5. Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; • demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive mësimore dhe veprimtarive tjera në shkollë/ institucion arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

2.6. Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndës

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me kompetencë i përmbajtjes shkencore në mësimdhënien e lëndës së Gjuhës shqipe”</p> <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen analiza të sakta nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes; • analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment; • analizon dhe jep gjykimet e tij për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimit letrare, si dhe për shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare; • kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe jo letrare; • shkruan ese me tematika që lidhen me çështje të ndryshme arsimore; • respekton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Konceptet e fushës së Gjuhës shqipe, pritshmëritë për nxënës të zbërthyer në KB për Nivelet e arsimit (ISCED II dhe ISCED III); • Kurrikulat lëndore të lëndës së Gjuhës shqipe (klasat 6-9 dhe 10-12) – pjesa e koncepteve të përgjithshme gjuhësore dhe rezultatet e përgjithshme të të nxënësve ; • Tekste të lëndës së Gjuhës shqipe, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

3. Modele të testeve për mësimdhënës të lëndës Gjuhë shqipe

Modelet e testeve për provimin e kualifikimit për mësimdhënës të Gjuhës shqipe janë zhvilluar dhe organizuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore dhe kompetencat në të cilat verifikohen njohuritë dhe shkathtësitë e mësimdhënësve, me qëllim marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie, në nivelin arsimor përkatës, në AMU apo në AML.

Modelet e testeve për provimin e kualifikimit për marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie i gjejmë të organizuara në gjashtë fusha kryesore, ku pjesë e tyre janë kompetencat bazë të cilat së bashku me rezultatet e pritshme janë referenca në hartimin e kërkesave/pyetjeve të testeve.

Tabela në vijim prezenton përmbledhjen e fushave – rubrikave të testit të provimit të kualifikimit, për të cilat zhvillohen kërkesat/pyetjet sipas tri niveleve të arritjeve.

Nr.	Rubrikat e testit	Pikë në test	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli bazë V)1 = 1 pikë	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli mesatar V)2 = 2 pikë	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli i lartë V)3 = 3 pikë
1.	Dokumentacioni zyrtar shkollor	4 pikë	0	2	0
2.	Kurrikula - Programi lëndor	6 pikë	0	3	1
3.	Aspekte të metodologjisë dhe pedagogjisë	13 pikë	4	3	1
4.	Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale	3 pikë	1	1	0
5.	Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	4 pikë	0	2	0
	Totali i pyetjeve pjesa 1	30 pikë	5	11	2
6.	Përmbajtja shkencore e lëndës	40 pikë	5	10	5
	Totali i pyetjeve të testit	70 pikë	10 pyetje	21 pyetje	7 pyetje

Modelet e testeve në vijim, përfshijnë disa kërkesa/pyetje (jo të gjitha në numër) për secilën fushë – rubrikë të provimit të kualifikimit për mësimdhënës. Ato kryesisht përmbajnë pyetje me alternativa të shumëfishta, por edhe pyetje të tjera, sipas niveleve të vështirësisë, me mundësi të përgjigjeve të sakta në një e më shumë alternativa.

3.1. Modeli i testit të lëndës “Gjuhë shqipe”, Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU)

Modelet e testeve në vijim, përfshijnë disa kërkesa/pyetje (jo të gjitha në numër) për secilën fushë – rubrikë të provimit të kualifikimit për mësimdhënës. Ato përmbajnë pyetje me alternativa të shumfishta, sipas niveleve të vështirësisë, me mundësi të përgjigjeve të sakta në një e më shumë alternativa.

I. Dokumentacioni zyrtar shkollor

1. Bazuar në Ligjin për Arsim Parauniversitar në Kosovë (2011), Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED-së, ka detyra dhe kompetenca të veçanta. Cila prej detyrave në vijim nuk është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Këshillit drejtues të shkollës: **1 pikë**
 - a. të hartojë rregullat e shkollës, për t’u miratuar nga komuna;
 - b. të vendosë për shfrytëzimin e buxhetit të pagave për personelin e shkollës;
 - c. të miratojë aktivitetet jashtëkurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës;
 - d. të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve.

2. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të: **1 pikë**
 - a. parimeve kryesore të kurrikulës dhe kompetencave kryesore të kurrikulës;
 - b. parimeve kryesore të kurrikulës dhe fushave të kurrikulës;
 - c. parimeve kryesore të kurrikulës dhe fushave të cilësisë së shkollës;
 - d. parimeve kryesore të kurrikulës dhe qëllimeve të arsimit parauniversitar

II. Kurrikula – Programi lëndor i Gjuhës shqipe

Programi lëndor

3. Për ndërtimin e kompetencave të lëndës, nxënësi punon: **1 pikë**
 - a. çdo orë mësimi;
 - b. vetëm në disa orë të veçanta;
 - c. vetëm gjatë një periudhe;
 - d. vetëm gjatë një viti mësimor.

4. Shënoni me V nëse pohimi është i vërtetë, ose me G nëse pohimi është i gabuar. **3 pikë**
- Programi i gjuhës shqipe mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani dhe programi mësimor i Gjuhës shqipe. _____
 - Në programin e klasës së nëntë janë sugjeruar 25 orë mësimore për përgatitjen e nxënësve për testin e arritshmërisë, lënda "Gjuhë shqipe". _____
 - Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. _____

III. Aspekte të metodologjisë dhe pedagogjisë

5. Gjatë planifikimit të testit, hapi i parë që duhet të kryejë mësimmshënësi, është: **1 pikë**
- Hartimi i skemës së vlerësimit të testit;
 - Përcaktimi i llojeve të pyetjeve dhe i pikëve që do të ketë testi;
 - Përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit;
 - Përcaktimi i rezultateve të të nxënit që do të vlerësohen në test.
6. Vlerësimi i të nxënit: **1 pikë**
- është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
 - ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.
 - mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë.
 - synon të zbulojë shkaqet e dobësive që kanë nxënësit në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korigjuese.
7. Gjykoni si është formuluar dhe është pikëzuar pyetja e mëposhtme?
Ç' lloj pyetjeje është ajo? **3 pikë**

Çfarë kanë të veçantë prapashtesat e fjalëve: *syçkat, gjethëzat*?
Cili është funksioni i këtij përdorimi?

3 pikë

- a. Formulimi i pyetjes:
-

- b. Pikëzimi i pyetjes:
-

- c. Lloji i pyetjes:
-

IV. Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale

8. Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësimdhënësi:

1 pikë

- a. Vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm;
- b. Përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh;
- c. Vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm;
- d. Përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

9. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G);

Në Rregulloret e komunës për arsimin parauniversitar, janë të përcaktuara detyrat që kanë të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar për zbatimin e saj.

- a. Është detyrë e institucionit arsimor të përkthejë Rregulloren komunale në udhëzime, rregullore të brendshme të shkollës, etj. për sjelljet që duhen krijuar e mbështetur, në kushtet e veçanta të institucionit përkatës arsimor; V/G _____ **1 pikë**
- b. Është detyrë e institucioneve arsimore të trajnojnë të gjithë prindërit dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal për parimet dhe qëllimin e Rregullore së shkollës. V/G _____ **1 pikë**

V. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

10. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

1 pikë

- a. Këshilli i prindërve të Kosovës;
- b. Këshilli i Prindërve të Kosovës;
- c. Këshilli i prindërve të Kosovës;
- d. Këshilli i prindërve të Kosovës.

11. Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme

3 pikë

- a. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë problemit të braktisjes së shkollës për të gjetur arsyet e vërteta dhe për t'i dhënë zgjidhje;
- b. Kur nxënësi i klasave IV-IX mungon më shumë se pesë dhjetë për qind të orëve totale vjetore të planit mësimor, mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor;

- c. Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes, kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.

VI. Përmbajtja shkencore e lëndës së Gjuhës shqipe

“Pylli” Mit’hat Frashëri

(Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)

Njëherë fati më shtyri në një qytet mbi zall të detit Zi, në Ineboll. Sado që thonë se ai det është shumë herë’ i kuq dhe i lik, udhëtimi im kish qenë fort i këndshëm. Po e vërteta ish se dhe stina ish pranverë, ëmbëlsi dhe bukuri e motit.

Inebolli ish shtrirë mbi zall, më të dy anë të limanit; shtëpitë e prapsme ngriheshin mbi një faqe, mbi piqinjt e një kodre; kodra ngjitesh bëhesh me majë dhe fare sipër kishte një godi të madhe. Padyshim një manastir, thashë se rreth godisë kish drurë, lisa të mëdhenj. Pra, kam se ç’ të shoh, e di tani ku të vete.

Në udhëtime të tillë njeriu duhet të mos harrojë dy gjëra: Të kënaqet me një hotel të dobët ose me një han të mirë, edhe të dijë të kërkojë, të gjejë, të zbulojë një gjë të interesojmë, një gjë që vlen të vizitohet, një gjë që të mos thotë njeriu se humbi kohën fare kot.

Si u mbaruan godit e fundit, zinte një pyll i vogël; drurët ishin të përzierë: veç drurëve me pemë që lamë përposh, në pyll kish shkozë, ah, panjë, dushk, lofatë, frashër: aty këtej lar, lar i Apollonit rrëfente fisnikun dhe të fortin drun» e tij, me lëvozhgën e limuar, me fletët si majë e shigjetë. Më lart akoma kish bredha, boriga, drurë të shkurtër, po të shëndoshë: lëkur’ e tyre e rrudhur dhe e çarë shtrydhtë lëngun e trashë, pisën e verdhë, një farë mjaltë të hidhur. Pas një sheshi të vogël, ku bari gjelbëronte dhe rrëfente ca njolla lulesh mbi kadifen e gjelbër, drurët rriteshin dhe më tepër, majat u ngjiteshin më lart, degët me gjethe u bashkoheshin.

S’ di gjë më të këndshme se t’ ecuret brenda në një pyll të dendur, ku trungjet lartësohen si shtyllas, kur degët dhe fletët, duke u përzierë atje në majë, formojnë një arkitekturë gotike që s’ e barazon dot kurrë mjeshtëri e njeriut; drita këtu mezi gjen një rrugë nëpërmes t’ atyre fletëve; sitet, kullohet thotë njeriu se pastrohet. Humbet fuqinë dhe merr një ngjyrë të venitur, si dritë e agimit; një mister, një ndjenjë pikëllimi mbretëron. Edhe kuptohet lehtë pse të moçmit e kanë adhurar pyllin, pse e kanë mbushur me perëndi, pse atje kanë pasur vendin e faljeve, e lutjeve, e mistereve, e shtresimeve të tyre.

Kostamoni, 18 korrik 1912

Për nga lloji ky tekst është:

1 pikë

- a. autobiografi.
- b. kronikë.
- c. tregim.
- d. udhëpërshkrim.

12. Cila nga fjalitë e mëposhtme demonstroi qëllimin e autorit për t'i sjellë tekstit nuanca bindëse:

1 pikë

- a. Padyshim një manastir, thashë se rreth godisë kish drurë, lisa të mëdhenj;
- b. Pas një sheshi të vogël ku bari gjelbëronte dhe rrëfente ca njolla lulesh mbi kadifen e gjelbër, drurët rriteshin dhe më tepër, majat u ngjiteshin më lart, degët me gjethe u bashkoheshin;
- c. Po e vërteta ish se dhe stina ish pranverë, ëmbëlsi dhe bukuri e motit;
- d. S' di gjë më të këndshme se t' ecurit brenda në një pyll të dendur, ku trungjet lartësohen si shtyllas, kur degët dhe fletët, duke u përzjerë atje në majë, formojnë një arkitekturë gotike që s' e barazon dot kurrë mjeshtëri e njeriut.

13. Si do të ndryshonte kjo pjesë nëse do të shkruhej në mënyrë objektive nga perspektiva e vetës së tretë?

1 pikë

- a. Do të fokusohet më shumë në dimensionet kohore.
- b. Do të jepte më shumë informacion për cilësitë e narratorit.
- c. Do të kishte më pak përmbajtje emocionale.
- d. Do të përmbante më pak detaje në lidhje me mjedisin.

14. Cilat detaje mbizotërojnë në paragrafin e dytë?

1 pikë

- a. Akustike
- b. Kohore
- c. Pamore
- d. Të gjitha së bashku.

15. Nga pikëpamja e organizimit të tekstit, paragrafi i parë shërben si hyrje. Zbuloni dy karakteristika të tij që lidhen me strukturën e tekstit.

2 pikë

- a. Karakteristika 1: _____
- b. Karakteristika 2: _____

16. Në paragrafin e tretë gjeni një figurë letrare që formohet nga burime sintaksore të shprehësisë. Zbuloni funksionin e saj. **2 pikë**
- a. Figura: _____
- b. Funksioni: _____
17. Përshkruani një ndjesi që krijon tek ju si lexues, paragrafi i katërt. Shpjegoni dy nga mënyrat me të cilat autori arrin të prekë ndjeshmërinë tuaj. **3 pikë**
- a. Ndjesia: _____
- b. Mënyrat: _____
18. Zbuloni një mjet gjuhësor që përdoret në përshkrimin e mjedisit. Cila teknikë e përshkrimit nxit përfytyrimin e lexuesve? **2 pikë**
- a. Mjeti gjuhësor: _____
- b. Teknika: _____
19. Gjeni një tipar të stilit romantik në këtë tekst. **1 pikë**
-

VII. Modeli i testit të lëndës "Gjuhë shqipe", Arsimi i Mesëm i Lartë (AML)

Dokumentacioni zyrtar shkollor

20. Bazuar në Udhëzimin për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie, kandidati ka të drejtë të ankohet ndaj procesit të licencimit dhe avancimit në karrierë. Ankesa me shkrim i drejtohet: **1 pikë**
- a. Drejtorisë Komunale të Arsimit;
- b. Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- c. Shkollës;
- d. Inspektoratit të Arsimit.
21. Vetëvlerësimi dhe analiza e detajuar dhe periodike e vetes mbi bazën e standardeve profesionale të përcaktuara me Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve dhe Udhëzuesin për vlerësimin e brendshëm për përtrirje të licencës së karrierës, i jep mësimdhënësit një mundësi të çmuar për të kuptuar pikat e tij të forta dhe ato të dobëta. Pësia e vetëvlerësimit nga mësimdhënësi nuk mund të jetë më e lartë se: **1 pikë**

- a. 15 %.
- b. 20 %.
- c. 25 %.
- d. 30 %.

Programi lëndor

22. Për ndërtimin e kompetencave lëndore, nxënësi punon:

1 pikë

- a. çdo orë mësimi;
- b. vetëm në disa orë të veçanta;
- c. vetëm gjatë një periudhe;
- d. vetëm gjatë një viti mësimor.

23. Shënoni me V, nëse pohimi është i vërtetë, ose me G, nëse pohimi është i gabuar.

3 pikë

- a. Programet e gjuhës shqipe mbështeten në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe planet mësimore të arsimit të mesëm të lartë. _____
- b. Në programet e klasës së dymbëdhjetë janë sugjeruar 16 orë mësimore për përgatitjen e nxënësve për provimin e Maturës Shtetërore. _____
- c. Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. _____

VIII.Aspekte të metodologjisë dhe pedagogjisë

24. Vlerësimi i të nxënit:

1 pikë

- a. është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
- b. ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.
- c. mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë.
- d. synon të zbulojë shkaqet e dobësive që kanë nxënësit në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

25. Gjatë planifikimit të testit, hapi i parë që duhet të kryejë mësuesi, është: **1 pikë**
- hartimi i skemës së vlerësimit të testit.
 - përcaktimi i llojeve të pyetjeve dhe i pikëve që do të ketë testi.
 - përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit.
 - përcaktimi i rezultateve të nxënësve që do të vlerësohen në test.
26. Cila nga format e mësimit konsiderohet më efektive për mësime të diferencuara në një klasë me nivele të ndryshme të nxënësve? **1 pikë**
- Mësimi frontal
 - Mësimi në grupe homogjene
 - Mësimi individual
 - Mësimi në grupe heterogjene

IX. Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale

27. Cila nga thëniet e mëposhtme përshkruan më mirë termin "Gjithëpërfshirje"? **1 pikë**
- Është besimi se nxënësit duhet të veçohen sipas aftësive të tyre.
 - Është besimi se disa nxënës nuk mund të mësojnë.
 - Është filozofia që të gjithë nxënësit kanë të drejtë të marrin arsim të barabartë në një sistem arsimor.
 - Është filozofia që nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë për shkolla speciale.
28. Mësuesja e Gjuhës shqipe ka planifikuar një vizitë me nxënësit e klasës XI/1 në Fakultetin e Filologjisë. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesja, në mënyrë që edhe Agoni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë këtë gjimnaz së bashku me shokët dhe shoqet e klasës? **1 pikë**
- i kërkon një mësues tjetër për ta shoqëruar Agonin në këtë vizitë.
 - shkon më parë në Fakultetin e Filologjisë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
 - e inkurajon dhe i kërkon Agonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.
 - i kërkon Agonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.

X. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

29. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

1 pikë

- a. Këshilli i prindërve të Kosovës
- b. Këshilli i Prindërve të Kosovës
- c. këshilli i prindërve të kosovës
- d. këshilli i prindërve të Kosovës.

30. Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme.

3 pikë

- a. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qendrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin e lartë dhe për tregun e punës.
- b. Nxënësi deri në moshën njëzetë e dy vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar.
- c. Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument në të cilin shënohet synimi i veprimtarisë dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.

XI. Përmbajtja shkencore e lëndës së Gjuhës shqipe

Prirjet në raportim

(Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)

Prindërit luajnë rol të madh në shkollë dhe kanë të drejtën të marrin raporte të rregullta nga shkolla për arritjet e fëmijëve të tyre. Duke qenë se ata vetë kanë pasur përvojat e tyre shkollore në të shkuarën, prindërit kanë pritshmëri të caktuara për sa i përket formatit të raporteve dhe se çfarë është e rëndësishme të përmbajnë ato. Mund të ekzistojë gjithashtu një hendek i konsiderueshëm brezash midis përvojave të prindërve në shkollë dhe asaj që ofrohet tani në shkollë.

Sigurisht, format e reja dhe më komplekse të vlerësimit që përdoren sot, kërkojnë forma të reja raportimi (Wiggins, 1998; Mc Tinghe dhe Wiggins, 2004). Nga ana tjetër, ndryshimet në raportim nuk janë të mirëpritura nga prindërit, nëse u krijojnë ankthe të tjera. Shumica e studiuesve janë të një mendjeje për parimet bazë të raportimit që janë:

- procesi i komunikimit duhet të jetë i drejtë, në kohë, konfidencial dhe i qartë (Loyd, 1997);
- baza mbi të cilën bëhet vlerësimi i performancës së nxënësve duhet të bëhet e njohur dhe të jetë e besueshme;
- pesha relative që u jepet kategorive që përbëjnë notën përfundimtare, duhet të bëhet e qartë dhe të jetë uniforme për të gjithë nxënësit dhe mësuesit;

- **çdo gjykim i përmbledhur që bëhet gjatë raportimit duhet të jetë i mbështetur nga fakte dhe të dhëna (Wiggins, 1998).**

Një numër shkollash po i ndryshojnë tani llojet e komunikimeve që u dërgojnë prindërve. Dërgimi me postë i një raporti me një faqe, një herë në semestër, që ka qenë dikur forma e vetme e komunikimit me prindërit, tani ka ndryshuar rrënjësisht. Tani shkollat përdorin sa më poshtë:

- raporte të ndryshme me shkrim;
- takime/intervista prindër-mësues;
- takime informuese për prindërit (zakonisht mbrëmjeve);
- fletëpalosje që shpjegojnë kurrikulën apo procedurat e reja të vlerësimit;
- gazetën e shkollës.

(Teksti është marrë nga libri "Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin" Colin J. Marsh)

31. Cila nga fjalitë e mëposhtme e shpreh më mirë idenë kryesore të tekstit? **1 pikë**

- a. Prindërit kanë të drejtë të informohen rreth arritjeve të fëmijëve të tyre.
- b. Format e reja të vlerësimit të nxënësve kërkojnë forma të reja raportimi.
- c. Ndryshimet në raportim nuk janë të mirëpritura nga prindërit, nëse u krijojnë ankthe të tjera.
- d. Prindërit luajnë rol të rëndësishëm në shkollë.

32. Struktura e tekstit është: **1 pikë**

- a. e krahasim- kontrastit;
- b. e problem- zgjidhjes;
- c. e shkak- pasojës;
- d. e renditjes së dukurive.

33. Cila nga alternativat do të ishte një mbyllje e përshtatshme për këtë tekst? **1 pikë**

- a. Çdo shkollë përzgjedh nga format e mësipërme të raportimit, sipas specifikave dhe mundësive të saj.
- b. Prindërit duhet të përshtaten me format e reja të vlerësimit të arritjeve të fëmijëve të tyre.
- c. Prindërit dhe mësuesit duhet të përcaktojnë së bashku se si do të vlerësohen arritjet e nxënësve.
- d. Drejtoria shkollës duhet të përcaktojë formate dhe modele të detyrueshme për raportimin e arritjeve të nxënësve.

34. Fjala *i përmbledhur* është formuar me:

1 pikë

- a. Përngjitje;
- b. Nyjëzim;
- c. Parashtesim;.
- d. Parashteso-prapashtesim.



Kosovo Legal
Services Company

IBE



EDUCATIONAL
RESEARCH
INSTITUTE



Ky dokument u prodhua me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe partnerëve të konsorciumit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.